



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E INSPEKTIMIT DHE MBIKËQYRJES

Nr. 950 Prot.

Tiranë, më 20.12.2024

URDHËR

Nr.129, datë 20.12.2024

**PËR
KRYERJEN E MBIKËQYRJES NË VAZHDIM NË LIDHJE ME ZBATIMIN E
VENDIMIT PARALAJMËRUES NR. 37, DATË 19.06.2024, TË
KOMISIONERIT**

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil mbikëqyr kryesisht ose me kërkesë të institucioneve, zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, në të gjitha institucionet që punësojnë nëpunës civilë.

Për këtë arsye,

në kushtet kur ka përfunduar afati i paralajmërimit dhe detyrat e lëna rezultojnë të pazbatuara, me propozim të Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, 14 dhe 15, të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes / inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit, e ndryshuar, me qëllim verifikimin e zbatimit të vendimit paralajmërues nr. 37, datë 19.06.2024, “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në institucionin e Bashkisë Belsh dhe paralajmërimin e institucionit për rregullimin e ligjshmërisë, me qëllim përmirësimin e situatës”, të Komisionerit,

URDHËROJ:

1. Fillimin e mbikëqyrjes në vazhdim për zbatimin e vendimit paralajmërues nr. 37, datë 19.06.2024, në institucionin Bashkia Belsh, sipas objektit dhe drejtimeve që përmban programi i mbikëqyrjes, i cili është pjesë e këtij urdhri.

2. Ngritjen e grupit të punës, me këtë përbërje:

Enkelejda Hebibasi	Drejtor i Zbatimit të Vendimeve Paralajmëruese dhe Koordinimit - <u>Drejtues i grupit</u> ;
Besjana Zyli	Inspektore në Drejtorinë e Zbatimit të Vendimeve Paralajmëruese dhe Koordinimit - <u>Përgjegjëse e grupit</u> ;
Stela Ndoka	Inspektore në Drejtorinë e Zbatimit të Vendimeve Paralajmëruese dhe Koordinimit - <u>Anëtare</u> ;
Helga Bojaxhi	Inspektore në Drejtorinë e Zbatimit të Vendimeve Paralajmëruese dhe Koordinimit - <u>Anëtare</u> ;
Elvis Qerimaj	Inspektor në Drejtorinë e Zbatimit të Vendimeve Paralajmëruese dhe Koordinimit - <u>Anëtar</u> ;
Erion Mata	Inspektor në Drejtorinë e Zbatimit të Vendimeve Paralajmëruese dhe Koordinimit - <u>Anëtar</u> ;

3. Mbikëqyrja në subjekt do të fillojë në datën **13.01.2025** dhe do të përfundojë në datën **24.01.2025**.
4. Në përfundim të procesit të verifikimit në subjekt, brenda një afati 60 ditor nga përfundimi i tij, do të përgatitet relacioni përkatës nga Drejtoria e Zbatimit të Vendimeve Paralajmëruese dhe Koordinimit, bazuar në aktet e konstatimit dhe procesverbalet e mbajtura në subjektin e verifikuar dhe dokumentacionin provues. Më pas do të hartohet vendimi përfundimtar i procedurave përmbyllëse të verifikimit të zbatimit të vendimit, i cili do t'i dërgohet institucionit.
5. Nëse gjatë procesit të mbikëqyrjes së zbatimit të vendimit paralajmërues nuk arrihen të respektohen afatet e vendosura, drejtuesi i grupit të punës duhet të kërkojë zgjatje afati tek Komisioneri, duke argumentuar edhe arsyet për mos përfundimin e procesit në afat.
6. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, nëpërmjet Drejtorisë së Zbatimit të Vendimeve Paralajmëruese dhe Koordinimit që të marrë masat për realizimin e procesit, duke filluar me njoftimin e subjektit që do t'i nënshtrohet mbikëqyrjes në përputhje me nenin 42 të Kodit të Procedurave Administrative dhe të akteve që janë pjesë e këtij vendimi.
7. Ngarkohet Drejtoria e Financave dhe Shërbimeve Mbështetëse që të sigurojë mbështetjen e grupit të punës me logjistikë, për vijimin normal të procesit, në përputhje me programin e miratuar.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA